VENDIM
Nr. 173, datë 4.11.2020

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "LENGARICA & ENERGY" SHPK NR. 306, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, NR. 105, DATË 18.8.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d" dhe neneve 8, 9 dhe 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116/3 prot., datë 22.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 10.8.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 62/22 prot., datë 11.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Lengarica & Energy" sh.p.k.

- Me shkresën nr. 947/1 prot., datë 13.8.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Lengarica & Energy" sh.p.k., me shkresën nr. 31 prot., datë 20.8.2020, protokolluar në ERE me nr. 974/2 prot., datë 21.8.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 18.9.2020, vendosi të shtyjë vendimmarrjen, pasi gjykoi të nevojshme që shoqëria të dërgojë në ERE informacion/sqarime shtesë për dokumentacionin në lidhje me sigurimin e energjisë elektrike dhe të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar.

- Shoqëria, në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 974/6 prot., datë 21.9.2020, me *email*-in e datës 14.10.2020, ka përcjellë dokumentacionin dhe sqarimet e kërkuara.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Në datën 26.6.2008 është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për qendrën kombëtare të biznesit ".

- Shoqëria "Lengarica & Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 306, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 18.8.2015.

- Aplikimi i shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7.1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 306, seria FK15, të shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 18.8.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 19.8.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit ahmeti